


Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturu Omladinu i Sport
Department of Culture Youth and Sports Administration

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024

Janar 2025

Raport i punës i Sektorit për Kulturë gjatë vitit 2024

10 janar – përmes web faqës së Komunës së Skenderajt është bërë Thirrja Publike për Projekte/Programe në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Më poshtë gjeni projektet që janë financuar nga DKRS

Përfituesit në Fushën e Sportit

Nr.	Emri i Projektit	Përfituesi/bartësi i projektit	Nr.Protokolli	Shuma e ndarë
1.	“Organizimi i Aktiviteteve garuese në Basketboll nga U12-deri te Senioret”	Klubi i Basketbollit SFERA	11-400/01-0007201/24	2,400.00 €
2.	“Organizimi i Garave Sportive në futboll U11 – U13”	SH.F.SUPERSPORT	11-400/04-0010125/24	500.00 €
3.	“Ndikimi i Notit tek mosha 6-12 vjet në sistemit eshtëror-muskulor”	Klubi i notit DIELLI	11-400/04-0008982/24	1000.00€
4.	“Vazhdimi i Organizimit të Klubit për të fituar të gjithë titujtë e mundshëm të FFK-së dhe pjesëmarrja në Champions League”	K.F.DRENICA-TRADITA	11-400/01-0009916/24	8,500.00€
5.	“Aktivitetet garuese të KF-Drenica, për të gjitha kategoritë”	K.F.DRENICA	11-400/01-0009833/24	74,000.00€
6.	“Mbështetje Financiare për Gara dhe ngritjen dhe zhvillimin e klubit të	KLUBI I GJIMNASTIKES	11-400/01-0010138/24	

	Gjimnastikes''			500.00€
7.	“Mbulimi i shpenizmeve të Klubit”	K.F.RUNIK UNITED	11-400/01-0007918/24	1,500.00€
8.	“Mbështetje Financiare për Gara”	K.P.P. SHPRESA	11-400/01-0019504/24	1,500.00€
9.	“Pjesëmarrje në Superligen A dhe Ligen Unike Gjergj Kastrioti,, Kosovë – Shqipëri”	KV.SKENDERAJ	11-400/01-009446/24	10,000.00€

Përfituesit në Fushën e Kulturës

Nr.	Emri i Projektit	Përfituesi/bartësi i projektit	NR.Protokolli	Shuma e ndarë
1.	“Fuqizimi Ekonomik i grave përmes promovimit të punimeve dhe veshjeve tradicionale”	OJQ DRUGËZA	11-400/01-0009186/24	500.00€
2.	“Ta ruajmë dhe kultivojmë Traditën “	OJQ ANSAMBLI DRENICA	11-400/01-0019300/24	4,500.00€
3.	Botim Libri “Ofshamë Izbice”	ALBERT ZEKAJ	11-400/04-0009797/24	1,000.00€

4.	Botim i Revistës "UJI" 2024	FATJONA BAJRA	11-400/01-0010110/24	600.00€
5.	"Transforimimi i shoqërisë përmes leximit"	KOSOVARE RAMDANI MEHMETI	11-400/01-0010115/24	500.00€
6.	Promovimi i talentëve të rinjë	REXHEP KAHIRIMANI	11-400/01-0009342/24	500.00€
7.	Botim i librit "Kopshti i ëndrrave"	FATLUME MEHMETI	11-400/01-0010130/24	1,300.00€
8.	Botim i librit historik "Komiteti për Bashkim dhe Përparim"	GENTRIT SMAKAJ	11-400/01-0010146/24	700.00€
9.	Botim Libri me Poezi "Vuajtje për një fjalë të lirë"	SELVETE NIMANI	11-400/01-0010099/24	600.00€

Përfituesit në Fushën e Rinisë

Nr.	Emri i Projektit	Përfituesi/bartësi i projektit	NR.Protokolli	Shuma e ndarë
1.	"Aktivitete Rinore"	OJQ SKENDERAJ LIVE	11-400/01-0010134/24	14,500.00€
2.	"Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në procese vendimmarrëse"	OJQ INICIATIVA QYTETARE	11-400/01-009949/24	1000,00€
3.	"Fushata për Shëndetin e Rinisë"	OJQ Qendra e Aspiratave Rinore	11-400/01-0010094/24	500,00€
4.	"Parandalimi i Drogave në Skënderaj"	Albiona Miftari	11-400/01-0010036/24	700,00€

5.	“Aktivitete Rinore Kulturore dhe sportive “	Gentrit Gashi	11-400/01- 0008973/24	700,00€
----	--	---------------	--------------------------	---------

-17 Shkurt - Dita e Pavarësisë së Kosovës. - Më shënimin e kësaj date Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe Kompleksin Memorial në Morinë. Seancë solemne e Kuvendit Komunal. **Turnir ne futboll te vogel dhe ne Basketball.**

-28 Shkurt - 26 vjetori i Betejës së Qirezit dhe Likoshanit - Kjo datë tash e disa vite është duke u shënuar në bashkëpunim me Komunën e Drenasit.. Këto dy komuna së bashku kanë bërë homazhe të varrezat e dëshmorëve dhe martirëve të rënë në betejën e Qirezit dhe Likoshanit.

- 4 Mars - Kemi qenë nikoqir i parakalimit te 150 automjeteve ” **Off –Road ”** ku kanë marrë pjesë shumë autoklube te qyteteve te Kosovës në itinerarin Skenderaj- Prekaz- Bjeshka e Mognës Istog.

-5, 6 dhe 7 Mars -26 vjetori - EPOPEJA E UÇK-së, java kulturore “Jetojmë me Lavdinë Tuaj”. Në kuadër të kësaj jave në komunën tonë u zhvilluan disa aktivitete kulturo-sportive tashme tradicionale.

- 5 Mars – Është mbajtur seancë solemne nga kuvendi komunal i Skenderajt, në nderim të sakrificës se Jasharëve me 5, 6 e 7 mars të vitit 1998. Është bërë zbulimi i pllakës perkujtimore në Burojë në lagjen Hoti në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta”

- 6 Mars - Ora e parë e mesimit i kushtohet Epopesë se Jasharajve

Homazhe perkujtimore në kompleksin memorial Adem Jashari dhe në Morinë

Zbulimi i Bustit te heronjve Sala dhe Hamit Jashari në Prekaz

Zbulimi i pllakës perkujtimore në Tushilë në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta

- 7 Mars

Përmbledhja e aktiviteteve zyrtare në shënim të Epopesë së UÇK-së, me pjesëmarrjen e gjerë të personaliteteve të jetës politike, kulturore dhe qytetarë të shumtë. Nga ora 18:00 në Komunën e Skenderajt u mbajt manifestimi „Nata e Zjarreve”, në orën 17:45 te varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Prekaz u ndezën flakadanët, rit ky tradicional dhe më pas në sheshin “Adem Jashari” u mbajt një koncert me këngë dhe valle. Në këtë koncert morën pjesë këngëtarë të estrades muzikore si dhe Ansambli Drenica dhe Ansambli shtetëror “ Shota “ .

- 12 Mars

Janë publikuar përfituesit e projekteve e OJQ-ve dhe personave fizik që kanë përfituar nga Thirrja Publike për Projekte/Programe në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Për 155.000 € subvencione kanë përfituar gjithsej 23, në fushën e Sportit 9 (nëntë) klube sportive, në fushën e Kulturës 9 (nëntë) OJQ dhe Persona fizik dhe në fushën e Rinisë gjithashtu 5 (pesë) OJQ dhe persona Fizik.

-18 Mars – Akademi perkujtimore kushtuar Ragip Jasharit në Qendren e Kulturës “ Hasan Prishtina”. Në këtë akademi perkujtimore kushtuar luftëtarit Ragip Jashari morën pjesë rreth 450 të ftuar. Akademia u organizua nga Shoqatat e Dala nga Lufta në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt perkatësisht Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

-24 Mars – Është mbajtur maratona Vrapimi i Marsit - Izbica

-26 Mars - Avancimet Kulturore “ Profesor Ajet Beqiri 2024 “

Është mbajtur aktiviteti kulturor, Avancimet Kulturore “Prof. Ajet Beqiri “2024, i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Ky organizim tashmë tradicional, ka karakter garues për nxënësit e shkollave fillore në dy fusha: Letërsi dhe Art Figurativ. Në të dy fushat juria profesionale zgjodhi më të mirët në mesin e shumë të mirëve. Në fushën e letërsisë ishin gjithsej 140 punime, edhe në fushën e Artit Figurativ kishte më shumë konkurent këtë vit, e qe për të dy juritë ishte e veshtirë të bënin perzgjedhjen e tyre për fituesit.

Çmimet në fushën e Letërsisë janë:

Ese

1. Çmimi i parë - Erëza Dani, Shfmu “ Ismet Uka “ Ticë shuma 50 euro
- 2 .Çmimi i dytë-Fatjon Gashi, Shfmu “ Shaban Jashari “ Skenderaj shuma 35 euro

3. Çmimi i tretë Alketa Tahiraj, Shfmu “ Idriz Barani “ Klinë e Epërme shuma 25 euro

Poezi

1. Çmimi i parë- Leonora Lani, Shfmu “ Halit Geci “ Llaushë shuma 50 euro
2. Çmimi i dytë - Aroma Deliu, Shfmu “ Malush Ahmeti” Rezallë shuma 35 euro
3. Çmimi i tretë – Era Mehmeti Shfmu “ Shaban Jashari “ shuma 25 euro

Çmimet në fushën e Artit Figurativ janë:

Vizatim

1. Çmimi i parë- Vlera Lushtaku, Shfmu “Shaban Jashari “ Skenderaj (shuma 50 Euro)
2. Çmimi i dytë- Dafina Selimi, Shfmu “ Idriz Barani “ Klinë e Epërme (shuma 35 euro)
3. Çmimi i tretë-Almedina Hoti, Shfmu “ Drenica” Polac (shuma 25) euro

Pikturë

1. Çmimi i parë -Vlera Beqa, Shfmu”Abedin Rexha “ Turiçec (shuma 50 euro)
2. Çmimi i dytë- Ledijon Veliqi, Shfmu “Drenica” Polac (shuma 35 euro)
3. Çmimi i tretë-Tokjona Xani , Shfmu “ Ahmet Delia” Skenderaj (shuma 25 euro)

Falenderojmë dhe familjen e Profesor Ajet Beqiri për bashkëpunimin dhe setin e librave që i dhuroi shkollës fituese.

Në këtë aktivitet moren pjesë 450 persona, vlenë të theksohet se ishte aktiviteti me më shumë nxënës pjesëmarrës dhe në publik se sa në vitin e kaluar.

26 Mars – Në Qendrën e Artit dhe Kulturës “ Hasan Prishtina “ u shfaq filmi dokumentar kushtuar deshmorit Mustafë Qorraj me regji të Shaqir Bejtes, ku edhe në këtë aktivitet moren pjesë diku afër 400 persona të ftuar. Ky film dokumentar u organizua nga familja e deshmorit në fjalë dhe në bashkëpunim me Komunen e Skenderajt përkatësisht Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

28 Mars – Masakra e Izbicës - U mbajt tubim perkujtimor në kujtim të 25 vjetorit të masakrës së Izbicës ku mbetën të vrarë 147 civil të pafajshëm. Në këtë tubim moren pjesë krytari i komunes, drejtor, zyrtarë dhe shumë qytetar për të nderuar dhe kujtuar viktimat kishte dhe disa fjalime rasti. Në këtë tubim perkujtimor moren pjesë afërsisht 850 - 1000 persona.

29 Mars - Në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina “ në Skenderaj u bë promovimi i librit me poezi me titull “ Ofshamat e Izbicës “ nga autori Albert Zekaj, libër ky që i dedikohet masakrës së Izbicës e ndodhur 25 vite më parë. Vlenë të theksohet se këtë libër e ka perkrahur financiarisht përmes subvencioneve Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport. Në këtë promovim ishin rreth 50 të pranishëm.

-05 Prill - Përkujtohet masakra e Rezallës

Në përkujtim të 25-vjetorit të masakrës së Rezallës u mbajt tubim përkujtimor dhe u bënë homazhe dhe nderime pranë Kompleksit të varrezave në Rezallë. Në këtë aktivitet morën pjesë strukturat e nivelit lokal dhe qendror, deputet dhe shumë qytetarë.

- 18 Prill – Në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina “ u shfaq filmi dokumentar “ Gratë e Lirisë” me regjisorë dhe autore Sala Ahmeti Çitaku dhe Melihate Termkolli. Në këtë dokumentar morën pjesë rreth 300 persona.

-30 Prill - Përkujtohen Komandanti Ilaz Kodra në 25-vjetorin e rënies së tij, si dhe 40 dëshmorët dhe 275 martirët e Drenicës. U bënë homazhe dhe nderime institucionale tek Kulla e heroit Ilaz Kodra në Prekaz po ashtu homazhe dhe nderime në Kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve në Marinë dhe Verboçë ku dhe ka rënë Komandanti Ilaz Kodra.

Ecja nga grupi i ish –pjestareve të TMK-së në itinerarin nga Kompleksi Përkujtimor Adem Jashari deri tek Kulla e Ilaz Kodres në Prekaz. Shfaqja e emisionit televiziv kushtuar jetës dhe veprës së Heroit Ilaz Kodra në emisionin Politiko në Kanal 10.

Është mbajtur Turneu memorial “Ilaz Kodra” në futboll. Ku morën pjesë rreth 300 persona.

- 07 Maj – Aktivitet të pastrojme Skenderajn

- 13 Maj - Homazhe në shënimin e përvjetorit të rënies së Dëshmorëve Tahir dhe Nebih Mehës në Prekaz.

- 31 Maj – është bërë promovimi i librit me poezi i autores së re nxënëse Tuana Meziu . Një shkrimtarë e re e cila bëri promovimin e librit në Shtëpinë e Kulturës Hasan Prishtina në Skenderaj që është një e re e cila premtonte shumë në botën e artit dhe shkrimit

- 07 Qershor - Në organizimin të DKRS-së përkatësisht, Sektori për Kulturë në kuadër të Ditës së Çlirimit të Skenderajt, më 7 qershor u mbajt edicioni i shtatembdhjetë i Festivalit Gjithëkombëtar

Teatrot Shkollore " Drenushat " Skenderaj 2024.

Pjesëmarrja ishte e kënaqshme. Në këtë festival u ndanë edhe çmime për më të mirët, nga juria profesionale. Në këtë festival morën pjesë SHFMU-ta.

Festivali u mbajt më 7 qershor 2024. Numri i nxënësve pjesëmarrës në gara në këtë festival ishte mbi 100 nxënës, ndërsa të njëjtat u përcollën nga një numër i nxënësve dhe prindërve rreth afër 400 persona gjithsej.

Shfaqjet e festivalit u vlerësuan nga juria profesionale dhe u ndanë mirënjohje dhe çmime.

10 Qershor 2024 - Në sallën e Kuvendit Komunal në Skenderaj u bë promovimi i librit „ Vuajtje për një fjalë të lirë” i autores Selvete Dervishi Nimani, liber ky i financuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport permes subvencioneve.

-18 Qershor 2024- Dita e Çlirimit të Skenderajt- Me shënimin e kësaj dite Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport bëri, homazhe në Kompleksin Përkujtimor në Prekaz, homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Morinë.

Seancë solemne e Kuvendit Komunal ku është shpallur qytetar nderi z. Bardhyl Mahmuti.

Është mbajtur Akademi Përkujtimore me rastin e 18 Qershorit si Dita e Dëshmorëve dhe Martireve të Komunes së Skenderajt në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina” ku morën pjesë rreth 500 të ftuar. U organizua edhe një Koktej Rasti me familjet e dëshmorëve. Është zbuluar shtatorja e heroit të vogël të Kosovës Leotrim Ahmetaj me një ceremoni mjaft mirë të organizuar ku morën pjesë rreth 2000 (dy mijë) qytetar, ekspozitë me fotografi të Skenderajt në Sheshin “ Adem Jashari “. Dhe në fund Koncerti për fëmijë i mbajtur po në shesh ku kishte shumë pjesëmarrës fëmijë dhe prinder.

22- Qershor Po ashtu në kuader të 25 vjetorit të Çlirimit të Skenderajt është mbajtur edhe Turneu Memorial tashme tradicional në Ping –pong “ **Dr. Fatmir Fazlija**” me rreth 100 të pranishëm.

-19 Korrik 2024- “Muaji i Diasporës” është organizuar nga Komuna e Skenderajt. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Për nder të Muajit të Diasporës Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport mbajtën një mori aktivitete për t’i argëtuar bashkatdhetarët tanë nga Diaspora.

Çdo natë për argëtimin e qytetarëve të Skenderajt dhe me gjerë, sidomos për qytetarët nga Disapora që ishin për pushime në vendlindje, janë përgatitur mbrëmje muzikore me shumë këngëtare të mirënjohur nga estrada kosovare. Në këtë aktivitet për gjatë gjithë muajit kanë marrë pjesë rreth 100 mij qytetarë.

Komuna e Skenderajt ka investuar në krijimin e hapësirave Sportive në Komunitetin, si projekt i fundit me rendesi për komunitetin është Poligoni Multifunksional në qytet i cili përfshin parkingun me kapacitet për 440 vetura, fusha sportive dhe kënd lojrash për fëmijë. Këto hapësira u mundësojnë qytetarëve të realizojnë aktivitete Sportive dhe rekreative në mënyrë me të lehtë. Të gjitha këto investime në poligone sportive në lagje të ndryshme të qytetit ofrojnë mundësi të rinjëve për aktivitete sportive në afërsi të vendeve ku jetojnë.

Komuna e Skenderajt ka 877997m² hapësirë për veprimtari sportive të cilat janë shfrytëzuar për aktivitete të ndryshme sportive të cilat janë realizuar gjatë vitit 2024, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor.

Me përkushtimin për krijimin e kushteve sa më të mira për nxënësit tanë është ndërtuar Poligoni Sportiv në oborrin e shkollës „Ahmet Delia“, i cili ka hapësirë 1000m². Kjo hapësirë rekreative dhe sportive synon të ofrojë mundësi të shumta për zhvillimin fizik, argëtimin dhe shëndetin e nxënësve.

-04 Gusht një organizim me një projekt të financuar nga DKRS u organizuar Street Ball Skenderaj 2024 ku morën pjesë Klube Sportive në Street Ball Skenderaj dhe kishte shumë pjesëmarrës dhe shikues adhurues të këtij sporti.

- 10 Gusht 2024 në ora 19:00 në Pllatonë e Shtëpisë ë së Kulturës, nga Ansambli “Drenica”, u shtrua Sofra Tradicionale me ushqime tradicionale të përcjellur me këngë, valle dhe anekdota të ndryshme. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë afërsisht 400 qytetarë, shumica kanë qenë mergimtarë që punojnë dhe veprojnë jashtë Kosovës.

Aktivitetet “Ditët e Mergatës” janë përmbyllur me datën 14 Gusht.

-Shtator – vizita të shumta të shkollave të qytetit dhe qytetarëve në Muzeun e Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina” për të parë nga afër artefaktet dhe ekspozitat e muzeut tonë.

23 shtator 2024- U bë thirrja publike për organizimin e Festivalit Gjithëkombëtar “Rapsodia Shqiptare” edicioni i 19-të.

29 Shtator Takimi nga Youth Community takim dhe hapje e ekspozites nje ditore me temen „Gjithëpërfshirja „ ku u prezantuan Punime ne Pikturë dhe Ese te krijuara nga artistet e rinjë . Punime te realizuara dduke u bazuar ne temat sociale qe rinia perballet cdo dite siq janë: Bullizmi, martesat e hershme , braktisja e shkolles , edukimi seksual , shendeti mendor dhe mediat sociale

-03 Tetor - Ora e Shkrimtarit- Bisedë Letrare, aktivitet ky i organizuar për hirë te krijimtarisë letrare te ish Ambasadorit Avni Spahiu. Ky aktivitet u mbajt në sallën e Qendrës se Kulturës dhe kishte perafërsisht 200 pjesëmarrës dhe te ftuar.

-Me 26. 27 dhe 28 Nëntor 2024 - Për nder të këtyre datave historike DKRS-ja përkatësisht Sektori për Kulturë organizon Festivalin Folklorik, Gjithëkombëtar “Rapsodia Shqiptare” edicionin e 19-të,

Me datë **05.10.2024** është formuar Bordi i Festivalit Folklorik “ **Rapsodia Shqiptare**”.

Anëtarët e këtij bordi janë:

1. **Alban Berisha**, Drejtor i Festivalit,
2. **Faton Zekaj**,anëtar,
3. **Xhevat Dervishi**, anëtar,
4. **Bleard Osmani**, anëtar
5. **Imer Loshi**, anë
6. **Albert Lushtaku**, anëtar
7. **Valbona Hoti**, anëtare
8. **Fehmi Lushtaku** anetar
9. **Albulena Lushtaku Ahmetaj**, anëtare
10. **Fehmi Ymeri**, anëtar
11. **Besmir Beka**, anëtar

Mbledhja e parë për festivalin folklorik “Rapsodia Shqiptare” e mbajtur me **17.10.2024** me drejtorin e DKRS-së dhe gjithë Bordin Organizativ, pas shumë diskutimesh rreth organizimit të festivalit, u caktuan edhe sektorët e bordit dhe sekretari i Festivalit. Gjithsej janë mbajtur 6 mbledhje te Bordit.

Në garën e Festivalit Folklorik Gjithëkombëtar “**Rapsodia Shqiptare**” Skenderaj 2024.

Nata e parë konkurruese 26 Nëntor 2024, kanë konfirmuar pjesëmarrjen. 17 grupe,

Nata e dytë konkurruese 27 Nëntor 2024, kanë konfirmuar pjesëmarrjen 21 grupe

Në natën e tretë konkurruese 28 Nëntor 2024 – nata finale e festivalit kanë performuar 20

- **28 Nëntor 2024 - Festivali Folklorik Gjithëkombëtar “ Rapsodia Shqiptare”** Qendra e Kulturës “ Hasan Prishtina” edicioni i 19-të. Nata finale e këtij festivali ku u shpallen dhe fituesit të cilet moren edhe çmime, vlenë të theksohet se ky është event i madh kulturor i organizuar nga komuna e Skenderajt gjeqësisht nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport i cili i dedikohet festave të Nëntorit dhe figurës së Heroit kombëtar Hamëz Jashari . Çmimi Kryesor është “ **Kulla e Jashareve** “ të cilin e rrembeu rapsodi i mirënjohur **Rifat Berisha** . Në këtë event për tri net radhazi morën pjesë mbi 1000 shikues. Për këtë aktivitet DKRS ka ndarë 19,200 (nëntëmbdhjetemijë e dyqind euro).

-28 Nëntor- Homazhe në Kompleksin memorial Adem Jashari dhe në Marinë.

-28 Nëntor - Zbulimi i Memorialit të daljës së Parë Publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Llaushë afër Shkollës Halit Geci. Në këtë aktivitet në bazë të të dhënave kanë marrë pjesë rreth 4700 persona.

- 28 Nëntor - Perfundimi i “Vrapimit të Nëntorit“ 28 kilometra, ndarja e çmimeve për fituesit e garës në Sheshin “Adem Jashari” në këtë aktivitet moren pjesë afërsisht 200 persona.

-11 Dhjetor – u mbajt festivali “ Poeti dhe Aktori” edicioni i dytë u mbajt në Prekaz dhe Skenderaj në këte aktivitet kishte pjesëmarrës rreth 60 poet nga vende të ndryshme të Evropës, aktivitet ky i organizuar nga Humanistja dhe poetja Flora Brovina dhe profesoresha Drita Begolli ndërsa si bashkëorganizator ishte edhe Komuna e Skenderajt – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Komuna i ka kryer transportin nga Prishtina në Skenderaj dhe anasjelltas si dhe drekën për të gjithë poetët.

30 Dhjetor – Me rastin e Ditës së Veteranëve, u bënë Homazhe pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, në Kompleksin Memorial në Prekaz si dhe në varrezat e dëshmoreve në Marinë.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 42 aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore me buxhet komunal.

Aktiviteti i përvjetshëm Sportisti i Vitit këte vit do të mbahet në Janar 2025

Raport i Biblotekës përfshirë edhe Biblotekat në teren

Perpunuesja e Librit :

Nr. I librave për sektorin e fëmijëve 9867

Nr. I librave për të rritur 16910

Nr. I librave në fondin librar 26777

Gjatë tërë vitit 2024 numri i lexuesëve të regjistruar në Biblotekë ishte mbi 400

Skenderaj 13.01.2025

Drejtori për Kulturë Rini dhe Sport

Alban Berisha